Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br. 1115-1160/20
Datë/Datum. 25.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksper. shqyrtues dhe nënshkrimi:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*
Ermal Shala:	21/12/2020	11/01/2021	*1115-1160/20*

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.12.2020, **OE "PBC" SH.P.K. – Prishtine**, ka parashtruar ankesë me nr: 1115/20, kundër njoftimit për anulim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër **"211-20-6152-2-1-1"**, me titull **"Krijimi i bazës qëndrore së të dhënave për regjistrimin e personave të zhvendosur dhe të të kthyerve"**, iniciuar nga AK – **MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM.**

Me datën: 28.12.2020, **OE NTSH UNISOFT – Prishtine**, ka parashtruar ankesë me nr: 1160/20, kundër njoftimit për anulim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër **"211-20-6152-2-1-1"**, me titull **"Krijimi i bazës qëndrore së të dhënave për regjistrimin e personave të zhvendosur dhe të të kthyerve"**, iniciuar nga AK – **MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **130,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 08.10.2020
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 09.11.2020
Vendimi i AK-së dhe letrat standarde: 04.12.2020
Ankesa në OSHP PBC SHPK: 08.12.2020
Ankesa në OSHP NTSH UNISOFT : 28.12.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE "PBC" SH.P.K. – Prishtine, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.
Neni 62 te LPP-se
Neni 43 dhe 44 të Rregullave dhe Udhezimeve Operativ të Prokurimit Publik

Hyrje

- AK – në Njoftimin e datës 4 dhjetor 2020, lidhur me Vendimin për Anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndër të tjera, parashtron se ky aktivitet anulohet nën arsyetimin se, shërbimet nuk po mund të kryhen në afatin e paparë si në njoftim për kontratë për shkak se ka pasë kërkesë për rishqyrtim nga OE, gjë që ka bërë të pezullohet aktiviteti i prokurimit si dhe të vazhdohet afati kohor për dorëzimin e ofertave.

- Më tutje, AK parashtron se, zyra e prokurimit për shkak që të mos hyj në obligime në lidhjen e kontratës me ndonjë OE, se afati për kryerjen e këtyre shërbimeve është shumë i shkurtër, bënë anulimin e këtij aktiviteti.

- Lidhur me Njoftimin e datës 4 dhjetor 2020, OE PBC, më 8 dhjetor 2020 kishte parashturar Kërkesë për Rishqyrtim. Neni 108/A, paragrafi 6, i Ligjit nr. 05/l -068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-237, parashtron:

"Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë."

- Duke qenë se që nga data 8 dhjetor, kanë kaluar mëse nëntë (9) ditë dhe AK – nuk ka vendosur lidhur me kërkesën, OE PBC, pashmangshëm duhet t'i drejtohet OShP-së, lidhur me Njoftimin e datës 4 dhjetor 2020, për shkak të mos-vendosjes nga ana e AK.

- Andaj - OE PBC, lidhur me Njoftimin e datës 4 dhjetor 2020, nuk pajtohet sepse i njejti është i përfshirë në shkelje të Nenit 62 të LPP-së si dhe, neneve 43 dhe 44 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Arsyetim

- Neni 62 i LPP-së, lidhur me përfundimin e aktivitetit të prokurimit, parashtron se AK mund ta përfundojë një Aktivitet të prokurimit vetëm për njërën nga arsyet:

- një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;

- të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

- para hapjes së tenderëve, ndërpreria e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit

të aktivitetit të prokurimit.

- Andaj – nga arsyetimi i Vendimit të AK-së, nuk del se përmbushen asnjëra nga arsyet e parapara në Nenin 62 të LPP-së. Nga arsyetimi i AK-së nuk del se është shkelur ndonjë lig aktual apo se mund të ndodhë në në procedurë të prokuimit; tenderët nuk përmbajnë çmime që tejkalojnë buxhetin e AK-së, si dhe, çfarëdo ngjarje objektive që ka rrjedhë me pastaj – nuk ka qenë e paparashikueshme, për shkak se nuk kemi të bëjmë me ngjarje të *vis majoris* të paparashikueshme, kur ato dihen botërisht se çfarë rrethana mund të jenë, e që në rastin konkret nuk janë prezente.

- Neni 44, në paragrafin 7 dhe 8 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik parasheh rastet kur duhet dhe kur mundet të anulohet procedura e prokurimit.

  Pika 7 e Nenit 44, parashtron se pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet:

  - Asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të parashikuar;
  - Asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm;
  - Numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE – është më pak se 3;
  - Nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara konkurruese në negociata më pak se 3;
  - Nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
  - Asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
  - Nëse urdhërohet nga organi shqyrtues i prokurimit; ose
  - Një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshim.

  Pika 8 e Nenit 44, parashtron se pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen:

  - Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së.

- Vlen të theksohet fakti se, OE PBC, më 8 dhjetor 2020, ka kërkuar qasje në dokumentacion ku edhe ishin prezent, mirëpo AK – ka thënë që dokuemntet mund t'i shiqoni por nuk mund të ju ipen kopje pasi që ka kërkesa për konfidencialitet.

- Përfundimisht – nga leximi i kushteve që duhet plotësuar në rastet kur duhet dhe mund të Anulohet procedura e prokurimit nga AK – del se asnjëra nga arsyet e sipërcituara nuk aplikojnë në rastin konkret dhe në shkaqet për të cilat është anuluar kjo procedurë e prokurimit.

- Andaj – OE PBC – kërkon nga OShP – që ta Aprovojë këtë Ankesë si të bazuar dhe ta obligojë AK – që t'i vazhdojë procedurat e prokurimit sipas dispozitave ligjore dhe dosjes së tenderit.

OE NTSH UNISOFT – Prishtine, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.
Neni 1 te LPP-se
Neni 7 te LPP-se
Neni 59 te LPP-se
Neni 60 te LPP-se
Neni 62 te LPP-se

Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1
Qëllimi

- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK - MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM nuk ka trajtuar ne parim RROUP dhe LLP sipas nenit 1.
Ne si OE NTSh UNISOFT, kemi aplikuar me një oferte financiare e cila është ne përputhje me planifikimet buxhetore, dhe me kërkesat te cilat janë kërkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate. AK - MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM nuk ka vepruar sipas rregullave dhe ligjeve te LPP, dhe komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit ka kryer shkelje te LPP me anulimin e këtij aktiviteti te prokurimi.

Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,5,6,7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK - MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM ofertën tone nuk e ka trajtuar ne baze te ligjeve te LPP, ka anuluar aktivitetin e prokurimit dhe me vendimin per anulim ne si OE NTSH UNIOFT jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar sipas LPP.
Dhe se ne si OE jemi oferte e pergjegjeshme dhe i plotesojme te gjitha kerkesat ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate. Andaj ne si OE jemi diskriminuar perkunder qe ne i plotesojme te gjitha kerkesat administrative. Kjo deshmohet me dokumentacionet dhe certifikatat te cilat ne kemi derguar ne dosjen e tenderit.

Neni 59 – paragrafi 4 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK - MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Ne si OE NTSH UNISOFT kemi dorezuar te gjitha dokumentacionet te cilat ajne kerkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate. Dhe se ne si OE jemi oferte e pergjegjeshme dhe i plotesojme te gjitha kerkesat ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate. Andaj ne si OE pretendojme qe AK nuk ka kryer ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve sipas kerkesave ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Neni 60 – paragrafi 1,2 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 60
Kriteret për Dhënien e Kontratës

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK - MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM nuk ka shperblyer me kontrate OE i cili eshte i pergjegjshem me cmimin me te ulet,ne si OE NTSH UNISOFT, jemi oferte e pergjegjeshme, pasi kemi dorezuar te gjitha dokumentacionet ne dosjen e tendeti dhe njoftimit per kontrate, dhe se oferta jone është e përgjegjshme.

Neni 620 – paragrafi 1,2 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
   1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
   2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
   2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK - MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM nuk ka anuluar aktivitetin e prokurimit pa u plotësuar asnjë nga kushtet të cilat janë saktësuar në nenin 62, se kur mund të përfundoj një aktivitet i prokurimit. Ne si OE NTSH UNISOFT, jemi oferte e përgjegjshme, pasi kemi dorëzuar te gjitha dokumentacionet ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate, dhe se oferta jone është e përgjegjshme.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli oshp që ti vlerësoj nëse OE me të lira se ne i plotësojnë kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe kërkesat e aneksit I te specifikacionit teknik, kjo pasi ne kemi kërkuar qasje, para kërkesës për Rishqyrtim mirëpo AK nuk na ka ofruar qasje në dokumentacionet e ofertës:

1. Inovativi SHPK,
2. PBC SHPK

Në pikat e lartecekura, ne kërkojmë nga OSHP që kërkesat tona at aprovoj si të bazuar dhe të veproj sipas ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi te LPP.
Lënda të kthehet në Rivlerësim.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. –.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Deklaratë nën betim - origjinal
2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës	Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës
3.Vërtetimin nga Gjykata themelore - Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për Seksioni III. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes se tenderit te Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4. Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.	Vërtetimin nga Gjykata themelore Origjinal ose kopje e noterizuar)
Profesionalna podobnost 1.Certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga MTI, ose regjistrimin e biznesit nga vendi i themelimit të ofertuesit (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)
2.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së	Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (Kopje)
3.Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal	Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal (kopje)
Ekonomski i finansijski kapacitet 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi financiar për tri vitet e fundit ka qenë minimum 260,000.00 €.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Raportin apo raportet e detajuara mbi qarkullimin financiar nga ndonje bank e licencuar në Kosovë
Tehničke i profesionalne mogućnosti 1. Listën e te punësuarve - Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit, udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve përkatëse, të prezantohen staf profesional a. Menaxheri i projektit duhet të ketë	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Listën e te punësuarve - Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit, udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve

minimum 5 vite përvojë në menaxhimin e projekteve ; Të dëshmohet me • CV, • përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar. • b. Ekspert për zhvillim të softuerit më përvojë mbi 3 vjeçare në zhvillim të softuerit, minimum 3 (tre); Të dëshmohet me • CV, • kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose (Certifikime të Microsoft në SQL Server dhe Certertifikata të Microsoft për administrimin e sistemit) certifikatat profesionale përkatëse e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtar ose të autorizuara nga ta, • për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar. c. Ekspert të bazave të te dhënave më përvojë mbi 3 vjeçare në administrim dhe zhvillim të bazave të te dhënave, minimum 1 (një) ; Të dëshmohet me • CV, • kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose (Certifikime të Microsoft dhe Microsoft në SQL Server) certifikatat profesionale përkatëse e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtar ose të autorizuara nga ta, • për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar. • Përvojë të punës me Microsoft SQL Server d. Ekspert për konfigurim të serverëve dhe ueb-shërbimeve (1) një. Të dëshmohet me • CV, • kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose certifikatat profesionale (MTA,MCSA,MCSE,MCP) • për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar.	përkatëse, të prezantohen staf professional a. Menaxheri i projektit duhet të ketë minimum 5 vite përvojë në menaxhimin e projekteve ; Të dëshmohet me • CV, • përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar. • b. Ekspert për zhvillim të softuerit më përvojë mbi 3 vjeçare në zhvillim të softuerit, minimum 3 (tre); Të dëshmohet me • CV, • kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose (Certifikime të Microsoft në SQL Server dhe Certertifikata të Microsoft për administrimin e sistemit) certifikatat profesionale përkatëse e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtar ose të autorizuara nga ta, • për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar. c. Ekspert të bazave të te dhënave më përvojë mbi 3 vjeçare në administrim dhe zhvillim të bazave të te dhënave, minimum 1 (një) ; Të dëshmohet me • CV, • kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose (Certifikime të Microsoft dhe Microsoft në SQL Server) certifikatat profesionale përkatëse e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtar ose të autorizuara nga ta, • për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar. • Përvojë të punës me Microsoft SQL Server d. Ekspert për konfigurim të serverëve dhe ueb-shërbimeve (1) një. Të dëshmohet me • CV, • kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose certifikatat profesionale (MTA,MCSA,MCSE,MCP) • për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar.
2. Listën e kontratave me referenca për shërbimet të njëjtës natyrë, e obligueshme minimum (2) dy kontrata të realizuara me sukses në lëmin e zhvillimit të softuerëve dhe mirëmbajtjes së sistemeve (softuerëve) në periudhën e shkuar tri vjeçare duke përfshirë, - Llojin e shërbimeve të përfshira, - Shumën e kontratës dhe - Datën dhe pranuesin.	2. Listën e kontratave me referenca për shërbimet të njëjtës natyrë, e obligueshme minimum (2) dy kontrata të realizuara me sukses në lëmin e zhvillimit të softuerëve dhe mirëmbajtjes së sistemeve (softuerëve) në periudhën e shkuar tri vjeçare duke përfshirë, - Llojin e shërbimeve të përfshira, -Shumën e kontratës dhe -Datën dhe pranuesin.
3. Afati i kryerjes së sistemit për menaxhimin e të dhënave duhet me qenë maksimumi 60 ditë kalendarike prej nënshkrimit të kontratës. Të dëshmohet me Plani dinamik me shkrim i kryerjes së shërbimeve, të nënshkruar dhe vulosur (origjinal).	3. Afati i kryerjes së sistemit për menaxhimin e të dhënave duhet me qenë maksimumi 60 ditë kalendarike prej nënshkrimit të kontratës. Të dëshmohet me Plani dinamik me shkrim i kryerjes së shërbimeve, të nënshkruar dhe vulosur (origjinal).

5.OE duhet te sjell kopje e certifikates valide te noterizuar e menaxhimit te cilesise ISO 9001	5.OE duhet te sjell kopje e certifikates valide te noterizuar e menaxhimit te cilesise ISO 9001
6.OE duhet te ofroj planin e intervenimit per afatin e kryerjes se sherbimeve per inspektim dhe rregullim e problemeve dhe kerkesave qe mund te paraqiten ne system bazuar ne Specifikimin teknik.	6.OE duhet te ofroj planin e intervenimit per afatin e kryerjes se sherbimeve per inspektim dhe rregullim e problemeve dhe kerkesave qe mund te paraqiten ne system bazuar ne Specifikimin teknik.
7.OE duhet te ofroj nje deklarate me te cilen siguron qe softueri I pershtatet specifikimit teknik te kerkuar.	7.OE duhet te ofroj nje deklarate me te cilen siguron qe softueri I pershtatet specifikimit teknik te kerkuar.
8.Dëshmija se anëtarët e stafit te propozuar janë në marrëdhënie pune te Operatori, te deshmohet me kontrata pune dhe CV.	8.Dëshmija se anëtarët e stafit te propozuar janë në marrëdhënie pune te Operatori, te deshmohet me kontrata pune dhe CV.

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI-VLERËSUES

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenët 59, 62 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE PBC SHPK:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimet ankimor të **OE "PBC" SH.P.K. – Prishtine** lidhur me anulimin e ofertës së tyre dhe anulimin e aktivitetit te prokurimit nga **AK – MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM** sqaron se AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 62 lidhur me anulimin e aktivitetit te prokurimit. AK dhe komisoni vleresues nuk ka kryer ekzaminim, vleresim te ofertave sipas LPP dhe ne perputhje me nenin 1 dhe nenin 59 te LPP. Arsyet e anulimit te aktivitetit te prokurimit nuk jane te bazuara dhe jane ne kundershtim me LPP.
Andaj pretendimet ankimore te OE PBC SHPK **jane te bazuara.**

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE NTSH UNISOFT – Prishtine:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimet ankimor të **OE NTSH UNISOFT – Prishtine** lidhur me anulimin e ofertës së tyre dhe anulimin e aktivitetit te prokurimit nga **AK – MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM** sqaron se AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 62 lidhur me anulimin e aktivitetit te prokurimit. AK dhe komisoni vleresues nuk ka kryer ekzaminim, vleresim te ofertave sipas LPP dhe ne perputhje me nenin 1 dhe nenin 59 te LPP. Arsyet e anulimit te aktivitetit te prokurimit nuk

jane te bazuara dhe jane ne kundershtim me LPP.
Andaj pretendimet ankimore te OE NTSH UNISOFT **jane te bazuara.**

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisoni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit duhet të kryejn vlerësim profesional duke respektuar nenët 1, 7, 59, 62 të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet **si të bazuar** dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim** për këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **AK – MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM.**
- Panelit Shqyrtues OSHP
- OE ankues **OE "PBC" SH.P.K. – Prishtine**
  OE NTSH UNISOFT – Prishtine